



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 668/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.09.2017 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Këkesë për propozim”, me nr. REF-16274-06-04-2017, me objekt “Blerje mallra kancelarie për nevojat të Nj.A të Bashkisë Dibër”, me fond limit 1.892.510 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k., në procedurën e prokurimit

**Ankimues:**

“Infosoft Office” sh.p.k.  
Adresa: Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Dibër  
Adresa: Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

*publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.06.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Këkesë për propozim”, me nr. REF-16274-06-04-2017, me objekt “Blerje mallra kancelarie për nevojat të Nj.A të Bashkisë Dibër”, me fond limit 1.892.510 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

II.2. Në datën 20.06.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 04.07.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- |                              |   |
|------------------------------|---|
| 1. “Infosoft Office” sh.p.k. | 1,351,819 lekë, (me TVSH), skualifikuar |
| 2. “Ylber Cani” p.f.         | 1,670,600 lekë, (me TVSH), skualifikuar |
| 3. “Colombo” sh.p.k.         | 1,785,000 lekë, (me TVSH), kualifikuar  |

II.4. Në datën 04.07.2017 operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

*Sipas procesverbalit të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mostrave, i ngritur me urdhër të titullarit të AK, rezulton që mostrat e paraqitura nga ky operator (konkretisht letra A4 nuk është sipas standartit të kërkuar nga autoriteti kontraktor që përbën zërin më të madh të preventivit), nuk përmbushin specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST e procedurës.*

II.5. Në datën 07.07.2017 operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

*Në këtë klasifikim janë bërë dy shkelje flagrante: Së pari, bashkëngjitur me këtë ankesë gjeni procesverbalin e datës 20.06.2017, mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mostrave, ku ndër të tjera thuhet: “Në praninë e komisionit të marrjes në dorëzim të mostrave dhe mallrave në orën 10:00 u paraqit vetëm operatori ekonomik “Infosoft Office” me anë të përfaqësuesit të tij ku kërkoi këqyrjen dhe marrjen në dorëzim të mostrave si më poshtë: Nga verifikimi i mostrave rezulton se ato janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në preventive.”*

*Pra, sic theksohet në PV, mostrat e paraqitura nga ana jonë plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të vendosura në DST. Për më tepër, për letrën A4 i vetmi specifikim i vendosur nga ana jonë ishte “letër A4, 80 Gr m 2 DWA”, ndërsa letra A4 e paraqitur nga ana jonë është letër A4, 80gr/m2, me ISO 9001:2008 për menaxhimin e cilësisë, me ISO 14001:2004 për menaxhimin e mjedisit, me ISO 9706 për ruajtje afatgjatë në arkiva, me Trutone Technology për rezultat maksimal në printimin e dokumentave me ngjyra (ngjyrat ngjisin mirë në letër dhe nuk zbehen me kalimin e viteve). Këto të dhëna teknike janë të stampuara edhe në paketimin e letrës që ju kemi sjellë si mostër dhe po jua dërgojmë edhe bashkëngjitur me foto. Nëse ju i referoheni germave “DWA” ato nuk janë specifikim teknik. Asnjë skedë teknike e letrave nuk ka ndonjë parametër apo specifikim teknik DWA. Atëherë cilin specifikim që ju keni shprehur në DST nuk kemi plotësuar? Shkelja e dytë që vërejmë të jetë bërë në këtë klasifikim, është kualifikimi si ofertë e rregullt e ofertës paraqitur nga operatori ekonomik Colombo, i cili nuk ka paraqitur mostra fare në këtë procedurë. Mostrat duhet të paraqiteshin deri më datë 20.06.2017, ora 10.00. Në PV e mbajtur me datë 20.06.2017 nga komisioni i marrjes së mostrave në dorëzim është shprehur shumë qartë, madje me germa të zeza të theksuara, që deri në afatin e përcaktuar nga ana juaj, U PARAQIT VETËM INFOSOFT OFFICE ME MOSTRA. Si mund të klasifikohet e rregullt oferta e OE Colombo që nuk paraqiti mostra fare, përderisa ju vetë keni përcaktuar në DST që mosparaqitja e mostrave është arsye për skualifikim? Ju vetë jeni shprehur në DST që “natyra e mallrave që kërkohen është specifike dhe e vecantë”. Si i verifikuat ju këto mallra specifike dhe të veçanta*

*përderisa nuk u paraqitën mostra nga OE Colombo. Dhe si mund të skualifikohet oferta jonë edhe pse kemi plotësuar të gjitha specifikimet dhe kërkesat tuaja dhe shumë më tepër?*

*Klasifikimi i datës 04.07.2017 është shkelje e hapur e një serie nenesh e rregullash të prokurimeve, duke filluar nga nenet 1, 2 dhe 20 të LPP, të cilat diktojnë procedura transparente, trajtim të barabartë të OE dhe mosdiskriminimin e tyre. Kështu jemi në kushtet e një pabarazie totale. Ne morëm masat për të plotësuar kriterin e AK për paraqitje mostrash dhe u paraqitëm në orar me të gjitha mostrat e kërkuara. Operatori tjetër as nuk mori mundimin të paraqitej, as nuk solli mostrat dhe shpallet fitues. Bazuar në nenin 46 dhe 53 të LPP, oferta e paraqitur nga ana jonë duhet të klasifikohet e rregullt (sepse kemi plotësuar të gjitha kërkesat dhe specifikimet) dhe duhet të skualifikohet OE Colombo sepse nuk ka plotësuar kërkesën për paraqitje mostrash në afatin e përcaktuar në DST.*

II.6. Në datën 14.07.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 3206/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar ankesën dhe argumentuar si më poshtë vijon duke bashkëlidhur Vendimin nr 1, datë 13.07.2017, nr. 41/11 prot, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave:

*Për sa i përket ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. në lidhje me arsyen e skualifikimit për shkak se mostrat e paraqitura nuk përmbushin specifikimet teknike sipas shtojcës 9 të DST, pas verifikimit të preventivit të mallrave të kërkuara nga ana e AK dhe njohjes me ankesën tuaj për ndryshimin e preventivave gjatë fazës së pranimit të ofertave me pretendimin se nuk duhet të specifikohen emrat e markave, ankesë kjo e bazuar në ligj, verëjmë se ju në ankesën tuaj nuk e keni cekur fare zërin e “Letër A4 80 Gr m 2 DWA” si zë preventivi për tu ndryshuar, pra nuk kishit asnjë vërejtje ndaj këtij zëri të preventivit sic keni pasur me të drejtë ndaj artikujve të tjerë. Meqenëse në DST në Shtojcën 9 citohet “Mosparaqitja e mostrave të kërkuara në standartet e cilësisë së kërkuar përbën arsye për skualifikim” sic e keni përcjellë edhe vetë ju në drejtim të AK në ankesën e bërë me këtë rast, mostrat e sjella nga ana juaj i përmbushin specifikimet përvec “Letres A4 80 Gr m 2 DWA” që është zëri kryesor në preventiv dhe është materiali bazë i punës për të gjitha zyrat e bashkisë dhe të të gjithë Nj.A në varësi të saj për të gjithë vitin 2017 dhe 2018 deri në kryerjen e prokurimit të ardhshëm në vitin 2018. Pra AK është në të drejtën e tij të kërkojë mallra cilësore pasi përndryshe do të bllokohej e gjithë puna e gjithë bashkisë, dhe meqenëse ju këtë artikull nuk e keni sjellë sipas preventivit të kërkuar kjo përbën arsye për skualifikim. Pra ankesa juaj nuk qëndron.*

*Për sa i përket dokumentit të paraqitur nga ana juaj me firmë të Komisionit të marrjes në dorëzim të mostrave ju bëjmë me dije se ky komision nuk është ngarkuar për verifikimin e cilësisë por vetëm për marrjen në dorëzim të mostrave pasi AK ka persona të tjerë për verifikimin e cilësisë. Megjithëse ju kanë firmosur një procesverbal ku deklarojnë që mostrat e marra në dorëzim përmbushin specifikimet teknike ky komision nuk është dhe nuk ka qenë i autorizuar për të kontrolluar cilësinë e mostrave të paraqitura, këto mostra janë verifikuar në momentin e vlerësimit të ofertave dhe jo në momentin e dorëzimit, pra procesverbali i paraqitur nga ana juaj vlen për faktin se ju keni dorëzuar mostra dhe jo për cilësinë e mostrave. Për sa i përket faktit se në procesverbal është cituar se jeni i vetmi operator ekonomik që më datë 20.06.2017 ora 10:00 jeni i vetmi O.E pas informacionit që KSHA mori nga Komisioni i marrjes në dorëzim të mostrave rezulton që më datë 20.06.2017 ju jeni i vetmi që keni dorëzuar mostra, por në DST e procedurës është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë të dorëzojnë mostra të mallrave*


*brenda datës dhe orës së hapjes së ofertave dhe jo specifikisht vetëm në ditën e fundit të dorëzimit të ofertave, pra ju nuk mund të dini se kush operator ekonomik ka dorëzuar mostra para kësaj date.*

II.7. Në datën 21.07.2017 operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike dhe kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k. sipas të njëjtave pretendime si në autoritetin kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 3490/1 prot., datë 22.08.2017, protokolluar me tonën në datën 24.08.2017 me objekt “*Informacion*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Në datën 30.08.2017, nëpërmjet shkresës nr. 1319/3 prot, Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të paraqiten pranë ambienteve të këtij komisioni, mostrat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, pjesmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 4052/1 prot, datë 12.09.2017, protokolluar me tonën me numër 1319/4 datë 14.09.2017, autoriteti kontraktor ka paraqitur fotokopje të proces verbalit nr. \_\_\_\_ (nuk ka numër protokolli), datë 20.06.2017 dhe mostrat origjinale të dorëzuara nga operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit.



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

### **Arsyeton**

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “*mostrat e paraqitura nga ana jonë janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në preventiv pasi sipas procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i marrjes në dorëzim të mostrave, ne i përmbushim specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe se operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k., i cili nuk ka paraqitur mostra fare në këtë procedurë*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.5, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

[...]

*Meqenëse natyra e mallrave që kërkohen është specifike dhe e vecantë dhe sasia është e konsiderueshme të gjithë subjektet të interesuar pjesëmarrës në procedurë duhet të paraqesin*

*mostra të produkteve brenda datës dhe orës e hapjes së ofertave. Mostra do të paraqiten për të gjithë artikujt përvec artikujve nga nr 45 – 57.*

III.1.3. Gjithashtu në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “*Specifikimet teknike*”, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

*[...]*

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

- Mallrat duhet te jene te gjithë cilesore dhe originale .*
- Mosparaqitja e mostrave te kerkuara ne standartet e cilesise se kerkuar perben arsye per skualifikim.*
- Ne rast se mallrat e dorezuara pas lidhjes se kontrates nuk do te jene ne perputhje me monstat e dorezuara Ak rezervon te drejten e prishjes se kontrates.*
- Per artiukujt nga nr 45-57 ne momentin e lidhjes se kontrates me AK do te percaktohen : Logoja, permbajtja standarte,etj*

III.1.4. Referuar ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe dokumentacionit bashkëlidhur kësaj ankese, operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Procesverbalin Nr.\_\_\_\_prot. (pa numër protokolli), datë 20.06.2017 “*Mbi marrjen në dorëzim të mostrave të mallrave për prokurimin me objekt ‘Blerje produkte kancelarie të Bashkisë Dibër’*” të mbajtur nga autoriteti kontraktor si dhe të firmosur nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mostrave, me përmbajtje si më poshtë vijon:

*“Pas këtyre procedurave Komisioni i marrjes në dorëzim i mostrave të mallrave është mbledhur në magazinën e Bashkisë Dibër në orën 10:00 në pritje të paraqitjes së mostrave dhe të mallrave të përcaktuar me objekt ‘Blerje produkte kancelarie të Bashkisë Dibër’.*

*Në praninë e Komisionit të Marrjes në dorëzim të mostrave dhe mallrave në orën 10:00 u paraqit vetëm operatori ekonomik “Infosoft Office” me anë të përfaqësuesit të tij ku kërkoi kqyrjen dhe marrjen në dorëzim të mostrave si më poshtë: Nga verifikimi i mostrave rezulton se ato janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në preventive.”*

III.1.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Procesverbalin Nr.\_\_\_\_prot. (pa numër protokolli), datë 20.06.2017 “*Mbi marrjen në dorëzim të mostrave të mallrave për prokurimin me objekt ‘Blerje produkte kancelarie të Bashkisë Dibër’*” të mbajtur nga autoriteti kontraktor si dhe të firmosur nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mostrave, me përmbajtje si më poshtë vijon:

*[...] “Pas këtyre procedurave Komisioni i marrjes në dorëzim i mostrave të mallrave është mbledhur në magazinën e Bashkisë Dibër në orën 08:00 – 11:00 në pritje të paraqitjes së mostrave dhe të mallrave të përcaktuar me objekt ‘Blerje produkte kancelarie të Bashkisë Dibër’.*

*Në praninë e Komisionit të Marrjes në dorëzim të mostrave dhe mallrave në orën 08:30 u paraqit operatori ekonomik “Infosoft Office” me anë të përfaqësuesit të tij ku kërkoi kqyrjen dhe marrjen në dorëzim të mostrave si më poshtë: Nga verifikimi i mostrave rezulton se ato janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në preventive sipas DST, përvec Letër A4 80 Gr m 2 DËA e cila nuk është e cilësisë së kërkuar dhe ky material është zëri kryesor në preventive dhe material bazë për punë në zyrat e AK. Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mostrave dhe Mallrave pasi verifikoi përmbushjen e specifikimeve teknike sipas DST për prokurimin me objekt ‘Blerje produkte*

*kancelarie të Bashkisë Dibër’, vendosi të marrë në dorëzim mostrat e paraqitura nga subjekti “Infosoft Office” sipas tabelës së sipërcituar dhe i garanton subjektit konfidencialitetin për dorëzimin e mostrave nga ana e tij.*

III.1.6. Bazuar mbi dokumentacionin e dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, konstatohet se procesverbalet e marrjes në dorëzim të mostrave për materialet objekt prokurimi janë dy dokumenta të cilët dallojnë nga njëri-tjetri. Operatori ekonomik ka paraqitur një procesverbal, i cili konfirmon se mostrat e paraqitura *“janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në preventiv”*, ndërsa autoriteti kontraktor në materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ ka paraqitur një procesverbal më anë të të cilit konstatohet se *“Nga verifikimi i mostrave rezulton se ato janë të njëjta me specifikimet teknike të kërkuara në preventive sipas DST, përvec Letër A4 80 Gr m 2 DËA e cila nuk është e cilësisë së kërkuar dhe ky material është zëri kryesor në preventive dhe material bazë për punë në zyrat e AK.”*.

III.1.7. Vlen të theksojmë se nga verifikimi i kryer këto dy procesverbale janë mbajtur në të njëjtën datë, nga i njëjti Komision i Marrjes në Dorëzim të Mostrave dhe për të njëjtin operator ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. Për më tepër në kthim përgjigje të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor është shprehur se ky komision nuk është ngarkuar për verifikimin e cilësisë, por vetëm për marrjen në dorëzim të mostrave, fakt i cili bie në kundërshtim me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k. ku autoriteti kontraktor shprehet *“Sipas procesverbalit të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mostrave, i ngritur me urdhër të titullarit të AK, rezulton që mostrat e paraqitura nga ky operator (konkretisht letra A4 nuk është sipas standartit të kërkuar nga autoriteti kontraktor që përbën zërin më të madh të preventivit), nuk përmbushin specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST e procedurës.”* Pra autoriteti kontraktor i është referuar vendimit të po të njëjtit Komision për marrjen në dorëzim të mostrave, fakt ky i cili tregon papërgjegjshmëri nga ana e autoritetit kontraktor dhe ka krijuar konfuzion për operatorin ekonomik ankimues, duke mbajtur dy procesverbale të ndryshme me dy vlerësime të ndryshme lidhur me mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.

III.1.8. Në nenin 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, përcaktohen parimet e përzgjedhjes së fituesit, citoj.....”Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;b) transparencë në procedurat e prokurimit;c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”*.

Gjithashtu në nenin 46, pika 1, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

III.1.9. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, në nenin 19/1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, ku përcaktohet “Komisioni i Prokurimit Publik*

është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Gjithashtu në nenin 64 pika 3 e të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik160, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”

III.1.10. Akoma më tej KPP mori në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues dhe ka verifikuar mostrat e operatorëve ekonomikë pjesmarrës të paraqitura nga autoriteti kontraktor. Nga ky verifikim rezulton se të dy operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit “Infosoft Office” sh.p.k. dhe “Colombo” sh.p.k. kanë dorëzuar mostrat pranë autoritetit kontraktor. Gjithashtu konstatohet se mostrat lidhur me produktin e vendosur në preventiv “Letër A4, 80 Gr m 2 DËA” janë të njëjta. Pra, mostra e paraqitur për produktin në fjalë nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. është e njëjtë me mostrën e paraqitur për produktin në fjalë nga operatori ekonomik “Colombo “ sh.p.k., oferta ekonomike e të cilit është kualifikuar nga autoriteti kontraktor. Për sa kohë autoritetit kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik “Colombo” sh.p.k. duke argumentuar se i plotëson të gjitha specifikimet teknike, atëherë rrjedhimisht duhet të kualifikohet edhe oferta e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. i cili ka paraqitur mostra të njëjta me operatorin tjetër të kualifikuar.

III.1.11. Gjithashtu veprimet e papërgjegjshme të autoritetit kontraktor vërehen edhe në faktin e cituar prej tij në kthimin e përgjigjës drejtuar operatorit ekonomik ankimues citoj... “Për sa i përket faktit se në procesverbal është cituar se jeni i vetmi operator ekonomik që më datë 20.06.2017 ora 10:00 jeni i vetmi O.E pas informacionit që KSHA mori nga Komisioni i marrjes në dorëzim të mostrave rezulton që më datë 20.06.2017 ju jeni i vetmi që keni dorëzuar mostra, por në DST e procedurës është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurë të dorëzojnë mostra të mallrave brenda datës dhe orës së hapjes së ofertave dhe jo specifikisht vetëm në ditën e fundit të dorëzimit të ofertave, pra ju nuk mund të dini se kush operator ekonomik ka dorëzuar mostra para kësaj date”, gjë e cila nënkupton se operatori ekonomik i kualifikuar i ka dorëzuar para kësaj date, kur në fakt nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP rezulton se mostrat janë dorëzuar prej tij në datë 20.06.2017, po në të njëjtën datë me atë të mbajtur për operatorin ekonomik ankimues.

III.1.12. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përsa kohë operatori ekonomik ankimues është njoftuar me procesverbal nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mostrave se mostrat e paraqitura nga ana e tij janë në përputhje me specifikimet teknike sipas DST dhe për sa



kohë nga verifikimi i kryer nga Komisioni i Prokurimit Publik mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. rezultojnë të njëjta me operatorin ekonomik oferta e të cilit është kualifikuar, autoriteti kontraktor duhet të kualifikojë operatorin ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.

III.1.13. Në kuadër të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mosdiskriminimit të tyre, autoriteti kontraktor duhet të mbajë të njëjtën linjë gjykimi dhe qëndrimi, pasi për fakte të njëjta nuk mund të veprojë në mënyra të ndryshme duke skualifikuar një operator ekonomik dhe duke kualifikuar tjetrin.

Gjithashtu KPP tërheq vëmendjen e autoritetit kontraktor për veprimet e tij të papërgjegjshme gjatë procesit të prokurimit publik (që nga pranimi i mostrave deri te shqyrtimi dhe vlerësimi përfundimtar i ofertave) që në procedurat e ardhshme të prokurimit të respektojë parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, ku përcaktohen parimet e përzgjedhjes së fituesit, citoj... “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. në lidhje me kualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit “Këkesë për propozim”, me nr. REF-16274-06-04-2017, me objekt “Blerje mallra kancelarie për nevojat të Nj.A të Bashkisë Dibër”, me fond limit 1.892.510 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1319 Protokolli**

**Datë 21.07.2017**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

